



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## Integrimi në Shqipëri dhe Europë i secilit prej nesh – Mbrojtja e të drejtave themelore dhe komunitetet e marginalizuara

E martë, 14 maj 2024, 10:00 – 12:00  
Shtëpia e Europës

### REKOMANDIME

#### Kuadri ligjor dhe kapaciteti institucional në Shqipëri

- Në Shqipëri ende mungon njohja ligjore e personave të komunitetit LGBTQIA+ duke filluar që nga identiteti i tyre gjinor apo seksual si dhe te të drejtat që derivojnë prej tyre, e drejta e familjes, mbrojtja sociale apo kujdesi shëndetësor. Për këtë rekomandohet që legjislacioni kombëtar të përditësohet dhe rishikohet duke marrë në konsideratë këto elemente për të siguruar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre në të gjitha aspektet.
- Rishikimi i Kodit Penal sa i përket pjesë së Gjuhës së Urrejtjes dhe Krimeve të Urrejtjes të jenë të sakta dhe të paraqiten në mënyrë sa më të qartë procedurat dhe standardet për ti identifikuar këto krime dhe për ti dënuar ato. Në Shqipëri nuk ka një praktikë dhe jurisprudencë të dedikuar që merret specifikisht me gjuhën dhe krimet e urrejtjes sidomos atyre që vijnë bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor të personave.
- Sa i përket Rishikimit të Kodit të Familjes është e nevojshme që të njihet me ligj bashkëjetesa e personave të së njëjtës gjini. Në Shqipëri nuk ka ende një mënyrë ligjore për të rregulluar bashkëjetesën e personave të së njëjtës gjini dhe kjo çon në mospërmbushje të të drejtave të njeriut duke qenë në shkelje të detyrimeve ndërkombëtare dhe konventave që Shqipëria aderon, por edhe të vet Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që përcakton të drejtën e çdo qytetari për të krijuar familje.
- Bashkimi European së fundi ka miratuar dy Direktiva për të garantuar standardet e organeve të barazisë me qëllim kryesor të fuqizojë kompetencat e organeve të barazisë për të luftuar diskriminimin në fushat e punësimit dhe sigurisë sociale, por gjithashtu për të rritur pavarësinë e tyre, për të rritur burimet njerëzore dhe teknike dhe për ti fuqizuar ato në drejtimin e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve në rastet e diskriminimit. Për këtë shteti shqiptar

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHG-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit European dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



inkurajohet që të marrë masat e nevojshme për të përafuar legjislacionin shqiptar me këto direktiva për të bërë të mundur për organet e barazisë në vend si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi fuqizimin e kapaciteteve, rolit dhe pavarësisë së tyre në linjë me direktivat e reja të BE-së.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit, si dy organet kryesore në Shqipëri për mbrojtjen e të drejtave të njeriut pavarësisht punës të mirë të bërë ndër vite hasin në vështirësi sa i përket ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe burimeve financiare dhe infrastrukturës dhe për realizimin e plotë të Strategjive apo Planeve të Veprimit të miratuara. Vlerësohet pozitivisht përfshirja e Shqipërisë në mekanizmin CERV si dhe asistencë teknike që po ofrohet nga TAIEX, po programe dhe mbështetje të tilla duhet të jenë më të shumta dhe të qëndrueshme për të siguruar që këto organe të realizojnë në mënyrë të plotë rolin e tyre dhe përgjegjësitë që kanë në këto fusha.
- Një rol të shtuar dhe më aktiv duhet të kenë dhe autoritetet lokale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke qenë që janë niveli i parë që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe komunitetin në nivel lokal duke ofruar shërbimet e nevojshme për këto komunitete.

### Roli i aktorëve të shoqërisë civile

- Rekomandohet një bashkëpunim më i madh dhe një rol aktiv i organizatave të shoqërisë civile që në fokus të punës së tyre kanë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjes së komunitetit LGBTQIA+ me institucionet publike dhe organet e barazisë në Shqipëri. Ato mund të kontribuojnë duke ofruar informacion të saktë dhe real mbi problematikat që hasin gjatë punës së tyre në terren dhe kontaktit të drejtpërdrejtë që kanë me këto komunitete. Ky informacion shpesh është i vështirë për tu identifikuar nga institucionet publike, kështu që një bashkëpunim dhe komunikim i vazhdueshëm me OSHC-të do e lehtësonte punën e tyre në marrjen e masave si dhe në reagimin që duhet të vijë nga institucionet publike përgjegjëse.
- OSHC-të duhet të jenë më aktive sidomos në zonat rurale dhe qytete të tjera të Shqipërisë, ku për këto tema diskutohet shumë pak ose aspak dhe vështirësitë e personave LGBTQIA+ janë dhe më të mëdha. Në shumë raste në këto zona mungojnë shoqatat e dedikuara dhe të specializuara, por ato mund të asistohen në ngritje kapacitetesh dhe ekspertize nga shoqatat

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



ombrellë e me më shumë eksperiencë nëpërmjet bashkëpunimeve dhe rrjeteve që mund të krijohen.

- OSHC-të inkurajohen që të jenë bashkëpunuese dhe me grupe të tjera interesi dhe aktorë të tjerë dhe sektorë të ndryshëm të shoqërisë si dhe të jenë më aktive për të shtyrë përpara ndryshimet e nevojshme ligjore duke i konkretizuar ato në masa dhe politika konkrete dhe të qarta dhe për ligjvënësit dhe përfituesit e këtyre politikave.
- Rekomandohet një përfshirje më aktive e OSHC-ve në procesin konsultues dhe politikëbërës duket u përfshirë dhe kontribuar me rekomandime në strukturat dhe mekanizmat e ngritura të konsultimit siç është dhe Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian, ku kontributi i tyre për politikat me fokus komunitetet e marginalizuara mund të prekin jo vetëm kapitullin 23 por dhe kapitujt e tjetër që përfshijnë arsimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen sociale, shëndetin publik etj.

### Informimi dhe ndërgjegjësimi

- Konsiderohet e nevojshme një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi mbi komunitetin LGBTQIA+ në Shqipëri, duke qenë që shpesh mungon informacioni mbi këtë komunitet si dhe ka rritje të rasteve të keqinformimit apo disinformimit që çon në rritje të diskriminimit dhe rrezikut të gjuhës së urrejtjes, krimeve apo dhunës ndaj këtij komuniteti. Këtë fushatë informimi duhet ta promovojnë OSHC-të që janë në pararojë por në bashkëpunim me median tradicionale dhe media sociale, me institucionet publike dhe aktorë të tjerë.
- Informimi dhe trajnime ndërgjegjësuese mbi komunitetin, të drejtat e tyre, mbrojtjen e tyre sugjerohet që të bëhet dhe me stafin pedagogjik (mësues të arsimit parauniversitar) por dhe me stafin psiko-social (psikologë, punonjësit socialë) që punojnë dhe kanë kontakt me të rinj dhe adoleshentë që shpesh bien pre e keqinformimeve dhe mund të jenë autorë të bullizimeve dhe gjuhës së urrejtjes, apo dhe për të rinjtë që identifikohen si pjesë e komunitetit por që diskriminohen dhe hasin vështirësi në pranimin e identitetit të tyre hapur.
- Media inkurajohet që të jetë më proaktive në promovimin e punës që organet e barazisë bëjnë, për të rritur kështu ndërgjegjësimin e personave të prekur që ti drejtohen këtyre

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



organeve në rastet e diskriminimit që ata mund të hasin. Shpesh ka një ngurrim dhe mosbesim për punën e tyre, duke qenë që qytetarët nuk kanë informacion që problematikat e tyre mund të gjejnë zgjidhje apo si të drejtohen në këto raste. Ankesat që vijnë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë një rritje nga viti në vit, por përsëri numri është i ulët në krahasim me rastet reale që ka në vend. Ndërkohë që Avokati i Popullit ka pasur zero ankesa këtë vit nga personat që janë pjesë e komunitetit LGBTQIA+. Kështu që sugjerohet si një praktikë pozitive që të ketë një mbulim më të gjerë nga media për punën e këtyre organeve dhe rasteve që ata zgjidhin në mënyrë që të informojnë dhe inkurajojnë qytetarët që të sjellin ankesa dhe problematikat e tyre.

- Rekomandohet që të ketë trajnime dhe ngritje kapacitetesh dhe për gazetarët dhe mediat për këto fusha, duke qenë që shpesh mungon informacioni i saktë dhe mediat kanë kontribuar dhe në nxitjen e keqinformimit për shkak se gazetarët nuk janë mjaftueshëm të informuar dhe përgatitur për çështjet që lidhen me komunitetin. Një vëmendje e veçantë duhet tu kushtohet dhe ngritjes së kapaciteteve të mediave lokale, që dhe për këto media që trajtojnë më në detaje jetën dhe përditshmërinë e qytetarëve të rritet ndërgjegjësimi dhe informimi për çështje të kësaj natyre.

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHG-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).*